

Mustafa IBRAHIMI  
Universiteti i Evropës Juglindore  
Tetovë, MAQEDONI  
Email: [m.ibrahimi@seeu.edu.mk](mailto:m.ibrahimi@seeu.edu.mk)

**MULTIKULTURALIZMI SI PROCES GLOBAL  
(PIKËPAMJE DHE PRAKTIKA)  
MULTICULTURALISM AS GLOBAL PROCESS  
(VIEWS AND PRAKTIKS)**

## **HYRJE**

Termi multikulturalizëm edhe pse mungon në shumë fjalorë sociologjikë, ai është i pranishëm në politikën kulturore dhe në jetën praktike të shumë shteteve bashkëkohore. Multikulturalizmi tregon qëllimin e bashkëjetesës së kulturave të ndryshme në një territor të caktuar. Në thelb, është dinamik, sepse përveç kulturës dominuese pranon edhe shumë kultura të pakicave. Në plan të parë del *mbrojtja e kulturës* dhe e *të drejtave të pakicës*. Një shembull të ngjashëm kishim në Kosovë, ku mënyra e trajtimit të kësaj problematike nuk solli rezultate, ndërkaq në Vojvodinë ndodhte e kundërta vazhdimisht afirmohej.

## **Çështje terminologjike**

Mbështetur në fjalorin enciklopedik të Grant Robertit, mësojmë se ky term për herë të parë është përdorur në vitin 1971, në një fjalim të kryetarit të atëhershëm kanadez **Pjer Tridoa**, i cili pat thënë: “*termi bikulturalizëm nuk e pasqyron sa duhet shoqërinë tonë. Fjala multikulturalizëm në këtë aspekt është më preciz*”.

Në fushën e politikës ky term përmbush dy qëllime kryesore: (1) ruajtjen e marrëdhënieve të mira midis pakicave të ndryshme etnike; dhe (2) definimin e raporteve midis shtetit dhe kolektiviteteve etnike (Sempri- ni 1999: 147).

Ranko Bugarski është i mendimit se duhet bërë dallimin midis termave: **multikulturë**, **multikulturalitet** dhe **multikulturalizëm**. **Multi- kultura**, sipas tij është shenja e ndonjë mjedisi; **multikulturaliteti** paraqet orientimin e përgjithshëm, i cili përkujdeset për këtë çështje; ndërkaq **multikulturalizmi** do të paraqiste politikën specifike dhe të përpunuar kulturore dhe arsimore të kësaj fushe (Bugarski 2002: 166).

**Interkulturalizmi** – nënkupton bashkëveprimin e shumë kultu- rave. Zakonisht ky lloj veprimi është dinamik, e thekson barazinë e të gji- tha kulturave në veprimet e tyre të përbashkëta. Në plan të parë është pa- surimi i tyre pa marrë parasysh dallimin e marrëdhënieve shumicë-pakicë.

### Kundërthëniet e pluralizmit politik

Është fakt i ditur, se grupet shoqërore nuk posedojnë fuqi dhe ka- pacitet të njëjtë, megjithatë konfrontimet janë të paevitueshme. Shembulli i Kanadasë jep të kuptohet se mospajtimet paraqiten për shkak të kufijve të dominimit ekonomik të shumicës anglofone mbi Kuebekun frankofon (Breton 1980). Për këtë arsye ekzistojnë edhe përpjekjet kryesisht separati- ste për pavarësi të Kuebekut frankofon. Kërkesat e tyre gjejnë mbështetje në aspektin ekonomik, gjegjësisht në relacionin eksploatues – i eksploa- tuar. Një logjikë identike është shënuar edhe në Belgjikë (raporti midis flamanëve dhe valonëve), si dhe në Spanjë, ku rritja e nacionalizmit kata- lonas koincidon me përfshirjen e Katalonisë në rajonet më të zhvilluara evropiane, të cilët i quajnë “Klubet e të pasurve” (Kimlika 1999: 63).

Përdorimi vetëm i vetëm një gjuhe, si gjuhë zyrtare në një shoqëri multikulturore, sjell pakënaqësi te pjesëtarët e gjuhës që janë në numër më të vogël, sepse këta nuk do të kenë fuqi administrative në strukturat shoqërore ose nuk do të jenë të barabartë me të parët. Të gjitha këto pad- rejtësi janë të lidhura me gjuhën, e cila për herë është konsideruar si shty- llë e një shoqërie. Sipas një rregulle, gjuhën zyrtare së pari e pranon klasa sunduese, pastaj popullsia qytetare e më pas fshati, dhe atje ku kundërvi- het gjuha e nënshtruar paraqitet dygjuhësia (Kalve 1981: 100).

Duke i krahasuar problemet e mëlartme me ato në Maqedoni, si- domos midis bashkësisë shqiptare dhe asaj maqedonase, vijmë në disa vle- rësime të sakta, por edhe kundërthënese. Ajo që është e saktë, është se po- pullata shqiptare prej fillimit iu kundërvu idesë për një gjuhë zyrtare në një shoqëri, siç është Maqedonia. Mirëpo, problemet nuk qëndrojnë në in-

teresat ekonomike ose politike, por në segregacionin dhe sjelljen jotolerante të kulturës njënacionale, gjegjësisht mungesën e pluralizmit kulturor.<sup>1</sup>

## Pluralizmi kulturor

**Pluralizmi kulturor** është i njëjtë me multikulturalizmin. Megjithatë, parë në aspektin historik, pluralizmi kulturor i ka paraprirë multikulturalizmit. Dallimi qëndron në faktin se pluralizmi kulturor paraqet sjelljen e barabartë, tolerante dhe të hapur midis kulturave nacionale, kurse multikulturalizmi kulturat i paraqet në një nivel subnacional. Andaj, pluralizmi kulturor është problem i vendeve në zhvillim (rasti i Maqedonisë dhe i shteteve të tjera të hapësirave ish-jugosllave), kurse shtetet e zhvilluara ballafaqohen me multikulturalizmin (shembulli i Kuebekut në Kanada, Spanjë, Belgjikë) (Semprini 1999: 149).

Shkalla e ulët e dallimeve kulturore, midis veti mund ta lehtësojë asimilimin dhe të çojë drejt homogjenizimit dhe formësimit të kulturave të ndërlikuara nacionale, por kjo nuk është gjithmonë kështu. Shpesh praktikohet dukuria që Frojdi e quante *narcizëm të dallimeve të vogla*, të cilat veprojnë në drejtim të gabuar, duke e theksuar dallimin kulturor në vend të ngjashmërive të kulturave të afërta. Ky është thelbi i dallimeve midis multikulturalizmit segregues dhe integruës (Pavković 1998: 155-170).

Multikulturalizmi segregues në hapësirën ballkanike fillon të dominojë bashkarisht me procesin e krijimit të shteteve nacionale gjatë shek. XIX, të cilat bazoheshin në njësimin e gjakut dhe tokës. Multikulturalizmin integruës e takojmë në ato shtete ku asnjëra prej tyre, nuk ka bazë për të pasur të drejtë ekskluzive ndaj asaj toke, siç është shembulli i Australisë dhe Kanadasë.

## Shoqëritë multikulturore në të kaluarën

Shumë popuj, që janë pakicë në shtetet shumëgjuhësore, nëpërmjet gjuhës shohin ardhmërinë e tyre. Në këtë mes gjuha kuptohet si armë kundër robërisë së huaj. Nëse në një shtet shumëgjuhësor orvatemi të krijojmë gjuhë të përbashkët, do të vijmë në situata të palakmueshme. Pse? Para së gjithash, ai shtet do të orvatet të garantojë sigurimin e mjeteve për komunikim të gjerë të nacionaliteteve të ndryshme dhe do të mundësojë integrimin e të gjithëve në jetën shoqërore. Por, ata të cilët për ata që kjo gjuhë është e huaj do të jenë të detyruar ta mësojnë me qëllim që të mos i keqësojnë kushtet e jetës së tyre qytetare. Duke falëndëruar përkthimet nga njëra palë, sidomos këtë e bëjnë pakicat, edhe pala tjetër do të ketë

---

<sup>1</sup> Këtë term, i pari e përdori Alen Lok, një nga figurat udhëheqëse të *New Negro Movementa*, i cili ka qenë i angazhuar për afirmimin e letërsisë zezake dhe artit figurativ në SHBA.

njohuri për ndonjë kulturë të caktuar. Por kjo formë e demokratizimit e bën më pak të mundur përdorimin e gjuhës së përbashkët, sepse çdokush e favorizon gjuhën e tij. Si kompromis duhet të përdoren të dyja gjuhët dhe të kategorizohen si gjuhë nacionale dhe zyrtare. Përkundër faktit se si pasojë rritet numri i botimeve me përmbajtje të njëjtë, sidomos në shkencë dhe teknikë, kjo situatë mund të lindë nevojën për gjuhë të përbashkët, që mund të jetë më ekonomike. Kjo mund të ndodhë në shtetet e ndryshme me ndonjë gjuhë nacionale, që nuk është zyrtare në atë shtet, kështu ka qenë me latinishten në shekullin XVIII dhe sot mund të jetë me anglishten si gjuhë e përbashkët.

Përparësia e dygjuhëtarëve është se janë të aftë t'i njohin ndryshimet subtile midis kuptimit të dy fjalëve dhe mosmashttrimit, sepse ai që njeh dy gjuhë nuk mund të mashtrohet nga format joharmonike të fjalëve. Nga kjo aftësi e dyfishtë, dygjuhëtarët paraqiten si dhënës të univerzales.

**Shembulli 1:** Nëse kthehemi në të kaluarën, doemos shtrohet pyetja: *a ishte dhe sa ishte Perandoria Osmane shoqëri multikulturore?*

Edhe pse Austro-Hungaria dhe Turqia Osmane, në kohën e tyre quheshin “Terr i popujve” – vështruar nga distanca e sotme historike na dalin si shoqëri më të matura multikulturore, se sa pasardhësit e tyre – shtetet kombëtare. Sepse këto të fundit të gjitha deri në një garonin se si, nëpërmjet mohimit të së drejtës së përdorimit të gjuhës së pakicës e sidomos traditës kulturore t'i rrudhin dhe shtypin pakicat kombëtare (Semprini 1999: 154).

Nëse parimi “*Një shtet për çdo popull, i tërë populli në atë shtet*” pranohej në shek. e 19-të, nuk do të shkatërrohej asnjë nga perandoritë shumënacionale të Evropës (Austro-Hungaria, Perandoria Osmane, ish-Bashkimi Sovjetik, ish-Jugosllavia etj.). Gabimi i tyre ishte se në territoret e bashkuara, përveç dominimit politik lejuan përdorimin e vetëm një gjuhe zyrtare. Pikërisht ky term, gjuhë zyrtare përbën gjuhën e etnikumit shumicë, pra gjuhën e shtetit. Ky term është i domosdoshëm në shtetet njëgjuhësore, ku termi gjuhë zyrtare përputhet me gjuhën nacionale. Por konfrontimi lind kur në shtetet shumëgjuhësore, gjuhë zyrtare bëhet njëra nga gjuhët nacionale. Ndërkaq gjuhët e tjera nacionale që nuk janë zyrtare pjesëtarët e tyre nuk kanë të drejtë t'i përdorin në nivele të ndryshme të shtetit. Pa mos harruar këtu se për popujt e nënshtruar në atë shtet, gjuhët e tyre janë flamuj të ruajtjes së identitetit. Nënkuptohej, gjuha zyrtare, në formë të shkruar është *gjuha e administratës, arsimit, gjyqit, sektorit publik dhe ushtrisë* që me çdo kusht e kontrollon pushteti. Si mjet i fortë dhe i rëndësishëm i integritimit linguistik të pakicave edhe më tutje ngelet shkolla dhe institucionet e tjera, si: armata, administrata, mjetet e komunikimit, botimet.

**Shembulli 2:** Pas Luftës së Parë Botërore, kur u shtua numri i gjuhëve shtetërore në Evropë, u shtuan edhe kërkesat për formimin e shteteve të reja mbi rrënojat e perandorive centriste. Për habi ishim dëshmitarë të përsëritjes së historisë, sepse pas shkatërrimit të ish-Jugosllavisë dhe ish-Bashkimit Sovjetik numri i shteteve u rrit dukshëm. Në të gjitha këto perandori ose federata ekzistonte një gjuhë e përbashkët për gjithë shtetin shumëgjuhësor. Kuptohet që këto perandori, të gjitha kombeve të tjera u garantonin identitetin dhe integrimin në shoqëri. Por pa përyshtrim të gjithë ishin të detyruar ta mësojnë gjuhën e përbashkët, pavarësisht se ishte e huaj, vetëm e vetëm të mos i keqësojnë kushtet e jetës së tyre qytetare. Rezultatet janë të pritura: shpërbërja e këtyre perandorive.

**Shembulli 3:** Në perandorinë e dikurshme habsburge për gjuhët e pakicave ekzistonte një tolerancë relative: numëroheshin aq kombe sa edhe gjuhë amtare që paraqiteshin gjatë regjistrimit të popullsisë. Evropa, në anën tjetër ofronte edhe raste të kundërta. Përkundër dallimeve kulturore dhe përplasjeve që dilnin prej tyre, Belgjika arriti të ndërtohet si komb. Karakteri i fortë dhe fleksibil i institucioneve federale zvicerane kontribuuan shumë për krijimin e një shteti të njëjtë për të gjithë zviceranët.

Cila duhet të jetë strategjia politike për mirëkuptimin midis gjuhës shumicë dhe gjuhëve pakicë? Përgjigjen më të mirë në këtë pyetje e ka dhënë socialisti breton Emil Mason, i cili thotë: *Këshilla ime është që popullit t'i drejtoheni me gjuhën e vet dhe ai do të jetë në anën tuaj. Nëse nuk veproni kështu, atëherë do të shkoni pas hapave të qeverisë*. Më pas shton *“Nëse socialistët bretonë duam të fitojnë në Bretoni, duhet tu drejtoheni vëllezërve fshatarë në gjuhën e tyre, në gjuhën tonë të vjetër, të bukur dhe barbare* (Masson 1972: 205).

## Multikulturalizmi përballë multilingualizmit

Ekzistojnë shumë dëshmi për rolin e gjuhës në bashkësi të caktuarra njerëzore. Edhe përkundër shumë dallimeve, njerëzit gjithmonë kanë qenë të prirur të komunikojnë nëpërmjet kufijve gjuhësorë dhe kulturorë.

Ky komunikim imponon pyetje të ndryshme, si: *Cilat janë raportet midis gjuhëve, shtrirja e gjuhëve të mëdha në llogari të gjuhëve të vogla; vlerat simbolike dhe komunikative të gjuhëve; globalizimi dhe lokalizimi i gjuhëve?*

Shumë nga këto përgjigje i gjejmë në veprën „Lufta midis gjuhëve” të Luj Zhan Kalve-së, ku gjuha merr përmasa ndërkombëtare dhe paraqitet si faktor kryesor i mospajtimeve, grindjeve dhe luftërave të ndryshme lokale, rajonale, por edhe botërore. Organizmat e ndryshëm botërorë, kësaj çështjeje sot i kushtojnë një rëndësi shumë të madhe, sepse konsidero-

het një faktor fundamental dhe empirik në nivel botëror. Në Evropë dhe kontinentet e tjera me vëmendje të veçantë studiohen rastet e shumëgjuhësisë. Përkrah shumëgjuhësisë studiohet edhe shumëkulturalizmi, edhe pse, nga ky aspekt deri më tani shumë pak është punuar. Kohëve të fundit mbahen shumë takime dhe zhvillohen diskutime për dukurinë e shumëkulturalizmit. Kjo dukuri mund të vrojtohet nga tri pikëpamje: (1) **planetare**, (2) **shoqërore** dhe (3) **individuale**.

## 1. Pikëpamja planetare

Që nga rënia e kullës së Babilonit, njerëzimi është ballafaquar me shumëgjuhësinë. Është fakt i pakontestueshëm se bota është shumëgjuhësore. Cilado që të ketë qenë gjuha e parë që e kanë dëgjuar apo mësuar njerëzit dhe kudo që të ketë qenë e lokalizuar, përditë takohen me gjuhë të tjera. Ata sot janë në kontakt të pandërprerë me gjuhën e tjetrit dhe janë të detyruar të jetojnë me këtë realitet, pavarësisht në e kuptojnë apo nuk e kuptojnë, i duan apo nuk i duan, sundojnë me atë gjuhë, apo janë të nënshtruar (Kalve 1995: 47). Si dukuri planetare, shumëgjuhësia manifestohet me ekzistimin e mijëra gjuhëve. Është vështirë të përcaktohet gjuha e parë. Pikëpamjet e gjuhëtarëve janë të ndara rreth çështjes se ç'kuptojmë me semantemën gjuhë. Sipas disave nga 6000 gjuhë sa ekzistojnë sot në botë, vetëm rreth 30% e tyre e kanë statusin e gjuhës, të tjerat janë të folme pa norma gramatikore, apo që fliten nga ndonjë bashkësi e vogël. Ndërkaq, sipas të tjerëve të gjitha janë gjuhë, sepse shërbejnë për komunikim midis njerëzve. Lidhur me këtë çështje lind pyetja: *sa gjuhë dhe sa kultura ka në botë?* Kësaj pyetjeje nuk mund t'i përgjigjemi me saktësi, sepse, sipas Bugarskit, është shumë vështirë të përcaktohen kufijtë midis gjuhëve dhe kulturave (Bugarski 2005: 29).

## 2. Pikëpamja shoqërore

Shumëgjuhësia plotësohet si përdorim i më shumë gjuhëve në një bashkësi shoqërore. Kjo dukuri është masive në botë. Kudo në botë ekzistojnë shtete shumëgjuhësore. Kjo dukuri është e pranishme si në shtetet në zhvillim, ashtu edhe tek ato të zhvilluara. Kjo do të thotë se, kudo në planetin tokë, ku jetojnë njerëzit nuk ka shtet njëgjuhësor. Të gjitha shtetet ballafaqohen me shumë gjuhë, e jo vetëm me një gjuhë. Nga kjo del se shumëgjuhësia paraqet fatin e përbashkët njerëzor. Ky fenomen gjuhësor ka lindur shoqëritë shumëkulturore.

Rrallë do të gjejmë shtet njëgjuhësor, kurse shumë prej shteteve janë shtete të vërteta shumëgjuhësore, si: **Papua, Guineja e Re, Indonezia, Nigeria, India**. Në Evropë, edhe pse shumë shtete konsiderohen si shtete kombëtare njëgjuhësore (disa prej tyre edhe formalisht janë shumë-

gjuhësore, si: Belgjika, Zvicra dhe Finlanda, këtu mund të hyjnë edhe ish-federatat). Megjithatë, në jetën reale të gjitha shtetet evropiane janë shumëgjuhësore, me përjashtim të Islandës dhe Portugalisë. Në kontinentet e tjera ky fenomen as që mund të fshihet, sepse formula karakteristike evropiane: një komb, një shtet, një gjuhë, atje nuk kishte lëshuar rrënjë.

Vetëdija për trajtimin e shumëgjuhësisë si faktor kryesor është dukshëm e zgjeruar dhe është shumë aktuale. Nesër sigurisht do jetë edhe më aktuale (p.sh. në Bashkimin Evropian një e treta e mjeteve harxhohen për përkthime dhe ka tendenca që kjo shifër të rritet në të ardhmen, kuptohet me pranimin e shteteve të tjera). Në BE u jepet rëndësi gjuhëve kombëtare, gjuhëve për komunikim ndëretnik, gjuhëve për komunikim ndërkombëtar dhe global.

### 3. Pikëpamja individuale

Në komunikimin e përditshëm, çdo individ, së paku shërbehet me një gjuhë tjetër. Dukuria e dygjuhësisë është e përhapur në të gjitha kontinentet, si p.sh. në Afrikë dhe Azi. Kudo shumë njerëz vazhdimisht shërbehen me dy e më shumë gjuhë. Çdo njeri i arsimuar, në parim është shumëgjuhësor, por ngelet pyetja, çfarë në të vërtetë do të thotë dy gjuhë të ndryshme?

Nuk ka dyshim se shumëgjuhësia individuale paraqet dukuri masive në tërë botën dhe vazhdimisht rritet. Anglishtja, si gjuhë globale tani më ka përfshirë gjysmën e popullsisë së botës dhe ekziston tendenca e rritjes së vazhdueshme të numrit të tyre. Tashmë, njëgjuhësia paraqitet si anomali. Si duket homo-sapiensi, si qenie me kapacitet shumëgjuhësor evoluon edhe gjenetikiisht, edhe në aspektin hapësinor.

### Përfundime

Përkundër dallimeve midis termave *multikulturë*, *multikulturalitet* dhe *multikulturalizëm* njerëzit gjithmonë kanë qenë të prirur të komunikojnë përtej kufijve gjuhësorë dhe kulturorë. Kjo është dëshmuar përgjatë historisë në bashkësi të ndryshme njerëzore. **Multikultura** është shenja e ndonjë mjedisi; **multikulturaliteti** paraqet orientimin e përgjithshëm, i cili kujdeset për këtë çështje; dhe **multikulturalizmi** do të përfaqësonte politikën specifike e të përpunuar kulturore dhe arsimore të kësaj fushe.

Lindja e këtyre termave bëhet me dallime shumë të vogla kuptimore midis tyre, sepse disa nga këta terma *nuk e pasqyrojnë sa duhet shoqërinë tonë, ndaj edhe sinonimet që lidhen me këtë çështje ndihet nevoja t'i precizojnë më mirë kufijtë gjuhësorë dhe kulturorë të një shoqërie.*

Multikulturalizmi nuk do të jetë i kufizuar vetëm në thënie deklarative të ekzistimit të më shumë kulturave brenda një shoqërie. Ai këtyre kulturave do t'u japë fuqi të njëjtë, në të gjitha fushat e rregullimit shoqëror. Pikërisht për këtë, shpeshherë ballafaqohemi me probleme të ndryshme, sidomos kur një grup shoqëror për realizimin e interesave të veta politike apo ekonomike dominon mbi grupin tjetër.

### **Bibliografi:**

- AЖЕЖ, Клод (1997). *Душата на јазикот*. Скопје.
- BRETON, Raymond, G, REITZ, Jeffrey and VALENTINE, Victor. (1980). *Cultural Boundaries and the Cohesion of Canada*. The Institute for Research on Public Policy, Montreal.
- BUGARSKI, Ranko (2002). *Nova lica jezika*. Beograd: Bibliotek XX vek.
- DOMENAK, Žan – Mari (1991). *Evropa: kulturni izazov*. Beograd. Biblioteka XX vek.
- ЦБЕТАНОВА, Ганка (2007). *Културните разлики и општествената интеграција: Македонија пред и по рамковниот договор*. Скопје.
- CASTELLAS, Manuel (1997). European Cities, the informational society and global economy: An Gray and Jim McGuigan, *Studying Culture (An Introductory Reader)*, Arnold.
- KALVE, Luj Žan (1981). *Lingvistika i kolonijalizam*. Beograd. Biblioteka XX vek.
- KALVE, Luj Žan (1995). *Rat među jezicima*. Beograd: Biblioteka XX vek.
- KIMLIKA, Vil (1969). Etnički odnosi i zapadna politička teorija: *Habitus*, Novi Sad, broj 1.
- MASSON, Emile (1972). *Les Bretons et le socialisme*, Paris.
- PAVKOVIĆ, Aleksandar (1998). Multikulturalizam kao uvod u rasparčavanje države: slučaj Jugoslavije: *Sociološki pregled* broj 2.
- SEMPRINI, Andrea (1999). *Multikulturalizam*. Clio.
- SIGUAN M. (2004). *Jezici u Europi*. Zagreb: Školska knjiga.



## Përmbledhje

Në këtë shkrim shqyrtohen termat që kanë për bazë kulturën dhe gjuhën. Duke ditur se të gjitha shtetet moderne janë multikulturore, rregullimi i brendshëm dhe rrethanat e tjera bëjnë që edhe terma të tjerë të përdoren me kuptime të ndryshme. P.sh. një shtet mund të jetë multikulturor, por të gjitha shtetet nuk janë multikulturale dhe as multikulturaliste. Gjithashtu me rëndësi është në mënyrë sistematike të dallohen edhe termat **multikulturalizëm** dhe **interkulturalizëm**, të cilët ndonjëherë në mënyrë të paarsyetueshme përzihen. Nga ky aspekt nevojitet një përdorim i drejtë i termave që lidhen me multikulturalizmin. Me këtë rast është e nevojshme të bëhet dallimi midis termave që kanë për bazë kulturën dhe gjuhën, siç janë p.sh. **multikulturë**, **multikulturalitet** dhe **multikulturalizëm**; pastaj midis **bikulturalizmit**, **multikulturalizmit** dhe **interkulturalizmit**, si dhe midis **pluralizmit kulturor** dhe **multikulturalizmit**.

## Summary

Considering that all modern countries are multicultural, the internal legal arrangement and other circumstances in that country compel us to use other terms that bear different meanings. For instance, a certain country can be multicultural, however, not all other countries are multicultural and multiculturalist. Also, it is essential that a systematic differentiation is made on the following terms: **multiculture**, **multiculturalism**, and **multiculturalism**. Then we have the difference between the terms, such as **biculturalism**, **multiculturalism**, and **interculturalism**. And last comes the difference between **cultural pluralism** and **multiculturalism**, where both terms are sometimes unnecessarily confused. That being said, an accurate and correct use of these terms is necessary with a view to clearly defining some terms whose primary meaning is based on culture and language.